REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës:	2018:026155
Datë:	22.07.2019
Numri i dokumentit:	00419505

DKR.P.nr.168/2016

NË EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE -Departamenti për krime të rënda në Pejë, Kryetari i Trupit Gjykues- Gjyqtari, Sylë Lokaj, anëtaret e trupit gjykues-Gjyqtaret Sami Sharragjiu dhe Sejdi Blakaj, e me pjesëmarrjen e Sekretares juridike Binake Mulliqi si procesmbajtëse, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.16/2014, të datës 04.08.2016, e të ndryshuar me datë 30.01.2017, e të përfaqësuar nga Prokuroria Themelore Departamenti për krime të Rënda në Pejë, ndaj të pandehurve S B, E B, E R dhe F G, si bashkë kryes për vepër penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe për vepër penale në vazhdimësi mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë i të ardhurave, dhuratave apo dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPK-së, të pandehurit E B për vepër penale në vazhdimësi mos raportimi apo raportimi i rrem i pasurisë, të ardhurave, dhuratave apo dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë, në prezencën e Prokurores së Shtetit Sahide G, përfaqësuesit të të dëmtuarës Komuna e Klinës, Ali Shala, të pandehurit S B, mbrojtësve av. Gëzim Kollçaku nga Peja dhe av.Haxhi Milllaku nga Prishtina, të pandehurit E B, mbrojtësit av.Gëzim Baloku nga Peja, të pandehurit E R, dhe të pandehurit F G, mbrojtësit av.Besnik Berisha nga Prishtina, të majtura me dt.17.09.2018, dt.18 dhe 19.10.2018, dt. 03.12.2018, dt. 04.03.2019 dhe dt,27.05.2019, **me dt.29.05.2019,** ka marrë dhe publikisht ka shpallë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. S B , i biri i M , i lindur me në f. ...., nr. personal ...., me banim në Rr.”... .” ... e “R” në Prishtinë, përgatitja superiore shkollore, më parë Kryetar i Komunës së Klinës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovë, më parë i pa gjykuar, ndodhet në liri.

2. E B i biri I A i lindur me ... në f. Q K.K, nr. personal ... me banim në Rr.”...” p.n. në K, përgatitja superiore shkollore, më parë Zëvendës-Kryetar i Komunës së Klinës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovë, më parë i pa gjykuar, ndodhet në liri.

3. E R i biri i F, i lindur me ... në f. J K.K, nr. personal ..., me banim në Rr.” ...” ... .kati .. në Klinë, përgatitja superiore shkollore, më parë Drejtor i drejtorisë së Administratës të

2018:026156

Komunës së Klinës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovë, më parë i pa gjykuar, ndodhet në liri.

4. F G i biri i H, i lindur me ... në f. Q K.K, nr. personal ..., me banim në Rr.” ...” L I kati ... në Klinë, përgatitja superiore shkollore, më parë Zëvendës Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës,, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovë, më parë i pa gjykuar, ndodhet në liri.

I.

Kundër të akuzuarve S B, E B, E R dhe F G:
- ne kuptim te nenit 363 par.1 pika 1.1 te KPPK-së

REFUZOHET AKTAKUZA

Te akuzuar se :

I akuzuari S B ne cilësinë e Kryetarit të Komunës së Klinës, i akuzuari E B në cilësinë e deputetit të Kuvendit Komunal të Klinës dhe zëvendëskryetarit të Komunës së Klinës , E R në cilësinë e Drejtorit të shërbimeve publike dhe emergjencave të Komunës së Klinës dhe F G në cilësinë e deputetit të Kuvendit Komunal në Klinë, duke vepruar në bashkëkryerje, pasi që kanë rënë dakord se së paku gjashtë nga dhjetë banesave në pronësi të Komunës së Klinës duhet t’u caktohej një çmim për qira për vetvete dhe për eksponentët e partive politike të tyre pavarësisht se a plotësohej ndonjë kriter objektiv apo jo, S B duke qenë kryetar i degës së partisë politike PDK në Klinë dhe E R duke qenë sekretar i degës së partisë politike PDK në Klinë, E B duke qenë kryetari i degës së partisë politike AAK ne Klinë dhe F G duke qenë kryetar i degës politike LDK në Klinë, pasi që kanë rënë dakord që të ushtronin ndikim si udhëheqës partiak për të siguruar përkrahjen dhe votën e favorshme të deputetëve të Kuvendit Komunal të Klinës që kanë qenë anëtar të partive politike të tyre në të gjitha konsultimet që janë zhvilluar në procedurën administrativë për ndarjen e banesave, duke e përforcuarat kështu reciprokisht dashjen e tyre për të kryer veprën penale dhe i kanë kontribuar substancialisht veprave penale të bashkëkryesve, me dashjen për të përfituar dobi pasuror që ka konsistuar në caktimin e ndarjes për dhjetë vjet të banesave në pronësi të komunës së Klinës, për një çmim simbolik prej njëzetë euro në muaj dhe për E Rn dhe F Gn edhe me dashjen për t’i blerë banes që u ishin ndarë atyre në mënyrë të paligjshme me një çmim të favorshëm, kanë përfituar nga pozita dhe autorizimet zyrtare të tyre i kanë tejkaluar kufijtë e autorizimeve të tyre dhe nuk i kanë kryer detyrat zyrtare të tyre duke e përcaktuar dhe realizuar procedurën administrative për ndarjen e dhjetë banesave të komunës së Klinës ashtu që të mbizotëronin ndaj çdo aplikuesi tjetër, pavarësisht se a e kanë përmbushur ndonjë kriter objektiv apo jo, në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, duke përfshirë nenin 7, 8 dhe 9 të Ligjit nr.02/L-133, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe nenet 5, 7 dhe 9 të Ligjit nr.02/L-28, për Procedurën Administrative, Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregulloren për Ndarjen e Banesave për Shfrytëzim me Qiradhënie nr.01-360-449/09 të Kuvendit Komunal në Klinë të datës 29.01.2009, në ve çanti me datë 27.02.2009 S B e ka marrë Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.1 360-803/2009 për emërimin e pesë anëtareve të Komisionit për Banes me Qira, përgjegjës për saktësimin e kritereve për ndarjen e banesave dhe vlerësimin e kërkesave, duke e shkelur kështu ligjin me vetëdije dhe me dashje, gjegjësisht: a) ka marre pjesë në vendimmarrje gjatë procedurës administrative, duke pasur interes personal dhe financiar si aplikues, në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative dhe nenin 59.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, b) i ka përzgjedhur anëtarët e komisionit duke u bazuar përjashtimisht në besimin personal, pa saktësuar në vendim ndonjë arsye që e ka justifikuar përzgjedhjen e anëtarëve të emëruar, në

2018:026156

kundërshtim me nenin 9 të Ligjit 02/L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik:

-S B e ka udhëzuar Kryetarin e Komisionit Prenk Palushin, që në mbledhjen e Kuvendit Komunal të datës 27.05.2009, ta prezanton një listë prej dhjetë perfituesish si të paraaprovuar nga bashkëkryesit, pavarësisht nga të drejtat objektive të tyre duke shkelur kështu me vetëdije dhe qëllimisht Rregulloren dhe Ligjin nr.02/L-28 për Procedurën Administrative dhe nenet nga 7 deri në 11, e në veçanti nenin 11 par.V dhe XI të Ligjit nr.02-L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
-F G në takimin e Kuvendit Komunal të datës 27.05.2009, ka marr pjesë në diskutimin për aprovimin e listës prej dhjetë çështje përfituesve të banesave për t'u ndarë me qira (duke përfshirë edhe vetveten)duke e marrë fjalën në mënyrë që të mbronte listën e propozuar madje edhe pas momentit kur deputetët e tjerë të Kuvendit që ishin në listë ishin larguar nga takimi, duke marrë pjesë kështu në vendimmarrje në procedurë administrative duke pasur interes personal dhe financiar si aplikues, në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit nr. 02 – L – 29 për Procedurën Administrative, neni 59 të Ligjit nr. 03 – L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenet nga 7 deri në 11 të Ligjit nr. 02 – L – 133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe duke ushtruar ndikim mbi deputetët e Kuvendit Komunal të partisë politike të tij në kundërshtim me nenin 11 par. XI të Ligjit 02-L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Me datë17.09.2009, S B ka marr nëntë vendime përfundimtare në procedurën administrative për ndarjen e banesave me qira duke miratuar vendimin e Kuvendit Komunal të Klinës të datës 27.05.2009 në të cilin ishin identifikuar dhjetë aplikues të suksesshëm (duke e përfshirë vetveten), të cilët gjëja kanë pasur të drejtë që t'u ndaheshin banes dhe në veçanti e kanë marrë vendimin 01 nr.660-3952/09 me të cilën një banesë i është ndarë E b, Vendimi 01 nr.360-360-3953/09, me të cilën një banesë i është ndarë E Rt dhe Vendimi 01 nr.360-3951/09, me të cilën një banesë i është ndarë F Gt, duke e shkelur kështu ligjin me vetëdije dhe me dashje dhe gjegjësisht a) ka marrë pjesë në vendimmarrje gjatë procedurës administrative, duke pasur interes personal dhe financiar si aplikes, në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrative dhe neni 59.2 të Ligjit nr.03 – L040 për Vetëqeverisje Lokale, b) e ka aprovuar listën e aplikuesve të suksesshëm që ishin rekomanduar nga Komisioni pa kërkuar apo pa marrë nga ky komision, si organ që ka zhvillu hetimin gjatë procedurës administrative, ndonjë raport apo ndonjë arsyetim ligjor apo faktik për rezultatin dhe duke e ditur se Kuvendi Komunal nuk kishte kërkuar apo marrë ndonjë raport të tillë në kundërshtim me nenin 72 ë Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrative, c) e ka aprovuar listën e aplikuesve të suksesshëm të rekomanduar nga Komisioni dhe të miratuar nga Kuvendi Komunal duke qenë në dijeni se përfituesit e këtyre banesave nuk i kanë plotësuar kushtet që janë përshkruar ne nenet 4, 8 dhe 10 të Rregullores si dhe kushtet që janë përshkruar në nenin 2.2 dhe nenin 2.2.1 të Njoftimit Publik të Komunës së Klinës nr.360-1298-09 të publikuar me datë 14.04.2009 dhe d) e ka shkelur parimin e barazisë para ligjit siç është përshkruar në nenin 5 par.1 dhe 2 të Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrative, nuk e ka ushtruar detyrën e tij për të kërkuar nga Kuvendi Komunal që të shqyrtonte vendimin e datës 27.05.2009 duke e ditur se ky akt komunal binte ndesh me legjislacionin dhe interesat e komunitetit, në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit nr. 03 L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.
-Me datë 17.09.2009 E R ka marrë njërën prej vendimeve përfundimtare për ndarjen e banesave me qira duke e miratuar Vendimin e Kuvendit Komunal të Klinës të datës 27.05.2009, në të cilin ishin identifikuar dhjetë aplikes të suksesshëm (duke përfshirë vetveten) të cilët gjëja kishin pasur të drejtë t'u ndaheshin banesa, dhe në veçanti e ka marrë Vendimin nr.1360-3949/2019, me të cilin një banesë i është ndarë S B, duke e shkelur ligjin me vetëdije dhe me dashje, dhe gjegjësisht a) ka marrë pjesë në vendim ka marrë pjesë në vendimmarrje gjatë procedurës administrative, duke pasur interes personal dhe financiar si aplikes, në

2018:026156

kundërshtim me nenin 29 të Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrative dhe neni 59.2 të Ligjit nr.03 – L040 për Vetëqeverisje Lokale, b) e ka aprovuar listën e aplikuesve të suksesshëm që ishin rekomanduar nga Komisioni pa kërkuar apo pa marrë nga ky komision, si organ që ka zhvillu hetimin gjatë procedurës administrative, ndonjë raport apo ndonjë arsyetim ligjor apo faktik për rezultatin dhe duke e ditur se Kuvendi Komunal nuk kishte kërkuar apo marrë ndonjë raport të tillë në kundërshtim me nenin 72 të Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrative, c) e ka aprovuar listën e aplikuesve të suksesshëm të rekomanduar nga Komisioni dhe të miratuar nga Kuvendi Komunal duke qenë në dijeni se përfituesit e këtyre banesave nuk i kanë plotësuar kushtet që janë përshkruar ne nenet 4, 8 dhe 10 të Rregullores si dhe kushtet që janë përshkruar në nenin 2.2 dhe nenin 2.2.1 të Njoftimit Publik të Komunës së Klinës nr.360-1298-09 të publikuar me datë 14.04.2009 dhe d) e ka shkelur parimin e barazisë para ligjit siç është përshkruar në nenin 5 par.1 dhe 2 të Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrative, nuk e ka ushtruar detyrën e tij për të kërkuar nga Kuvendi Komunal që të shqyrtonte vendimin e datës 27.05.2009 duke e ditur se ky akt komunal binte ndesh me legjislacionin dhe interesa e komunitetit, në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit nr. 03 L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, e) e ka zëvendësuar Kryetarin e Komunës në detyrën e tij për të marrë vendim përfundimtar në procedurën administrative në kundërshtim me kriteret e zëvendësimit që janë përkufizuar me nenin 25 të Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrative, f) nuk e ka ushtruar detyrën e tij për të kërkuar nga Kuvendi Komunal që ta shqyrtonte vendimin e datës 27.05.2009 duke e ditur se ky akt komunal binte ndesh me legjislacionin dhe interesat e komunitetit, në kundërshtim me nenin 58 të Ligjit nr. 03 L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

-Pas marrjes së vendimeve përfundimtare të lartpërmendura në procedurën administrative për ndarjen e banesave me qira , S B dhe E R nuk i kanë informuar kandidatët e pa sukseseshëm për rezultatin e garës nl kundërshtim me nenet 109 deri në 113 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative dhe nenin 20 të Rregullores, duke i penguar personat e interesuar që të parashtronin ndonjë ankesë të suksesshme.

-E B dhe E R e kanë fshehur dokumentacionin që ka pasur të bëjë me procedurën administrative për ndarjen e banesave dhe në veçanti 49 kërkE origjinale që janë dorëzuar në lidhje me njoftimin publik të Komunës së Klinës Nr.360-1298/09 të publikuar me datë 14.04.2009, duke mos e përmbushur detyrën zyrtare të tyre për të siguruar dokumentacionin që është kërkuar nga Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëposhtëm AKK), me datë 27.09.2013 duke mos ia pamundësuar cilit do person të autorizuar të Komunës së Klinës që ta siguronte dokumentacionin e kërkuar nga AKK-ja, duke penguar kështu çfarëdo kontrolli administrativ ndaj të drejtës së bashkëkryersëve për t'u ndarë banesa me qira dhe duke u siguruar që të gjithë bashkëkryesit të vazhdonin të përfitonin dobi pasurore të paligjshme që ka konsistuar në shfrytëzimin e vazhdueshëm të banesave për një çmim simbolik të qirasë prej njëzet euro në muaj dhe duke e shkelur kështu me vetëdije dhe me dashje nenin 20 të Ligjit 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenin 9 të Ligjit 02- L-28 për Procedurën Administrativ dhe në këtë mënyrë kanë përfituar dobi pasurore që ka konsistuar në shfrytëzimin e vazhdueshëm të banesave që u janë ndarë në mënyrë të paligjshme për një vlerë totale të llogaritur si diferencë midis çmimit simbolik prej njëzetë euro në muaj për qira që i është paguar Komunës së Klinës dhe çmimit të tregut për banesa me qira (prej jo më pak se 200 euro në muaj) të shfrytëzuar me numrin e muajve gjatë të cilëve të pandehurit kanë vazhduar të përfitojnë dobi pasurore të paligjshme dhe në veçanti S B ka përfituar dobi pasurore të paligjshme që ka konsistuar në shfrytëzimin e vazhdueshëm të banesës nga data 12.01.2010 deri me datë 24.06.2014 të një banese prej 110 metra katror që i është ndarë në mënyrë të paligjshme dhe që gjendet në Komunën e Klinës, rruga "...", ndërtesa ..kati K-...për një shumë prej 9.720 euro.

E B ka përfituar dobi pasurore të paligjshme që ka konsistuar në shfrytëzimin e vazhdueshëm të banesës nga data 12.01.2010 deri me datë 04.08.2016, të një banese prej 110 metra katror që

2018:026156

i është ndarë në mënyrë të paligjshme dhe që gjendet në Komunën e Klinës, rruga "....", ndërtesa 1 kati K-..., për një shumë prej 13.680 euro.
E R ka përfituar dobi pasurore të paligjshme që ka konsistuar në shfrytëzimin e vazhdueshëm të banesës nga data 12.01.2010 deri me datë 04.08.2016, të një banese prej 110 metra katror që i është ndarë në mënyrë të paligjshme dhe që gjendet në Komunën e Klinës, rruga "... .", ndërtesa 1 kati K-.., për një shumë prej 14.400 euro.
-F G ka përfituar dobi pasurore të paligjshme që ka konsistuar në shfrytëzimin e vazhdueshëm të banesës nga data 12.01.2010 deri me datë 04.08.2016, të një banese prej 110 metra katror që i është ndarë në mënyrë të paligjshme dhe që gjendet në Komunën e Klinës, rruga "... ..", ndërtesa 1 kati K-.., për një shumë prej 14.400 euro, duke i shkaktuar dëm Komunës së Klinës që ka konsistuar në pagesë të paligjshme përkatëse gjithsej vlerën e dobisë pasurore të përfituar nga bashkëkryesit dhe duke ju shkaktuar dëm aplikuesve të tjerë që kanë marrë pjesë në procedurë e që janë privuar nga shansi legjitim për t'u ndarë atyre banesae lartpërmendura.

- me çka si bashkë-kryes, kishin për të krye vepër penale keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

- **për shkak se Prokurori i Shtetit në mungesë të provave, në fjalën përfundimtare ka hequr dorë nga ndjekja penale.**

Shpenzimet e procedurës penale ju ngarkohen mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

II

Te akuzuarit , S B dhe E B :

JANË FAJTOR

1.I akuzuari S B:
Për shkak se :
Në cilësinë e ti si Kryetar i Komunës së Klinës, në vazhdimësi nga muaj mars i vitit 2013 deri në muajin mars të vitit 2016, duke pasur obligim ligjor që në Agjensionin Kosovar Kundër Korrupsionit, ta dorëzonte për çdo vit një deklaratë për pronën, të ardhurat, dhuratat apo dobitë materiale të tjera sipas nenit 3, 5,8 të Ligjit nr.04/L-050 dhe të ndryshimeve të pastajme të tij, me dashje nuk ka deklaruar: për vitet 2012,2013,2014 dhe 2015, pronësinë mbi banesën në sipërfaqe prej 79 m2 që ndodhet në rrugën " ..." ....., hyrja ..., nr.... në Prishtinë dhe pronësinë mbi automjetin ..., në vlerë prej 65.000 euro.

- me çka ka kryer vepër penale mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave e dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare në kundërshtim me nenin 437 par.2 lidhur me nenin 81 par.1 te KPK-së.

2. **I akuzuari E B:**
Për shkak se:
Në vazhdimësi nga marsi i vitit 2015 deri në mars të vitit 2016, në cilësinë e zëvendës kryetar i Komunës e Klinës duke pasur obligim ligjore që në Agjensionin Kosovar kundër korrupsionit ta dorëzonte për çdo vit një deklaratë për pronën, të ardhurat, dhuratat apo dobitë materialë tjera sipas nenit 3 , 5 ,8 te Ligjit nr.04/L-050 dhe te ndryshimeve te pastajme te ti , me dashje nuk e ka deklaruar informatat për pronësinë token ne sipërfaqen prej 5.500 m 2, ngastrën kadastrale nr.1840-2, dhe 1840-12, zona kadastrale e D ne fshatin Q Komuna Klinë.

2018:026156

- me çka ka krye vepër penale mos raportimi apo raportimi i rrem i pasurisë , te ardhurave , dhuratave dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare ne kundërshtim me nenin 437 par.2 lidhur me nenin 81 par.1 te KPK-së.

Për këtë gjykata ne kuptim t e nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21 par. 2, 41, 43 par. 1 nën par. 1.2, dhe 1.3, 45 par.2, 46, 49 par.1 pika 1.1,50, 51,52,53, 73, 74 75 par.1 pika 1.2, 76 par.1 pika 1.6dhe neni 437 par.2 të KPRK-së, nenit 359, 360, 361, 365, 366, 367, 450, 463 par.1 dhe 2 të KPRK-së, **të akuzuarit i:**

GJ Y K O N

1.Të akuzuarin S B:

- me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj
- dënim gjobë në të holla ne shumë prej njëmijë (1.000) euro .

Dënimi me burg, fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht qe i akuzuari ne afat prej një viti nuk do te kryen vepër te re penale .

Dënimi me gjobë duhet te ekzekutohet ne afat prej 15 ditësh , e nëse i akuzuari nuk e ekzekuton apo e refuzon ekzekutimin i njëjti dënim do ti zëvendësohet me burg , duke llogaritur 20 euro për çdo ditë burgu .

I akuzuari detyrohet qe gjykatës ne emër te paushallit gjyqësorë të ja pasguaj shumen prej 30 euro, ndërsa në emër te kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 50 euro .

2.Të akuzuarin E B :

- me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh
-dënim gjobë në të holla ne shumë prej njëmijë (1.000) euro .

Dënimi me burg, fare nuk ka për tu ekzekutuar me kushte qe i akuzuari ne fat prej një viti nuk do te kryen vepër te re penale .

Dënimi me gjobe duhet të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh , e nëse i akuzuari nuk e ekzekuton apo e refuzon ekzekutimin i njëjti dënim do te zëvendësohet me burg , duke llogaritur 20 euro për çdo ditë burgu .

I akuzuari detyrohet qe gjykatës ne emër te paushallit gjyqësorë të ja paguaj shumen prej 30 euro , ndërsa ne emër te kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 50 euro .

Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh pasi qe aktgjykimi te merë formën e prere

A r s y e t i m

Aktakuza:
Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës, me aktakuzën PPS.nr.16/2014, dt.04.08.2016, e të ndryshuar me dt. 30.01.2017, i ka akuzua të pandehurit S B, E B, E R dhe F G, si bashkë-kryes për vepër penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPK-së, secilin veç e veç për vepër penale mashtrimi në detyrë nga neni 426 par.1 dhe 2 të KPK-së të pandehurin S B për katër vepra penale mos raportimi apo raportimi i rremë

2018:026156

i pasurisë i të ardhurave, dhuratave apo dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPK-së, dhe të pandehurin E B për dy vepra penale mos raportimi apo raportimi i rrem i pasurisë, të ardhurave, dhuratave apo dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 të KPK-së.

Sipas kundërshtimeve, me aktvendimin P.nr. 168/16 dt. 10*.04.2018, janë hudh pikat 2, 3, 4,5 të aktakuzës kundër të pandehurve* S B, E B, E R dhe F G, të akuzuar secili veç e veç për vepër penale mashtrimi në detyrë nga neni 426 par.1 dhe 2 të KPK-së *dhe procedura penale për pikat e akuzës përkatëse është* ***përfundua****, ndërkaq janë refuzua kundërshtimet për pikat tjera të aktakuzës.*

Në shqyrtim kryesorë, përfaqësuesja e aktakuzës, Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore DKR. në Pejë, S G kla mbete në tersi pranë aktakuzës kualifikimit të njëjtë juridik të veprave penale.

2.Pjesa refuzuese:
Prokurorja e Shtetit fjalën përfundimtare e tha:Pas administrimit te provave në shqyrtim kryesorë, nuk është provua që te akuzuarit S B, E B, E RR dhe F G ta kenë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 te KPPK-se sikur qe akuzohen , andaj hjeki dorë nga ndjekja penale për këtë vepër penale.

Me që Prokurori i Shtetit, ka heqë dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarve S B, E B, E R dhe F G, të akuzuar si bashkë-kryes për vepër penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPK-së, Gjykata në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 te KPPK-së e ka refuzua aktakuzën ndaj të akuzuarve dhe ka vendosë si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

3.Pjesa fajësuese:
Provat e administruara: Janë administrua dëshmitë formale:Regjistri për deklarimin e pasurisë për të akuzuarin S B: dt. 25.03.2013, dt. 11.03.2014, dt. 27.03.2015.
Kontratën mbi dhuratën e banesës Vr.nr.7466/2006 dt.30.08.2016, Aktvendimin mbi regjistrimin e pronë[s nr.011-952-1-1131 dt.29.04.2015 kontrata mbi shitblerjen L.R.P.1954/2015 nr. Ref. 458?2015 dt.04.06.2015, Kartela financiare për tatimin në pronë dhen nga Komuna e Prishtinës në Prishtinë dt.17.06.2016
Përgjigja e gjykatës themelore dega në Lipjan dt. 03.02.2016
Kërkesa për informacion drejtuar kompanisë së ujësjellësit dt. 09.03.2016.
Kërkesa e PK-së për informacion drejtuar kompanisë rajonale pastrimi në Prishtinë dt. 09.03.2016,
Kërkesa e PKës për informacion drejtuar kompanisë Shpërndarjes dhe emergjence – EDS në Prishtinë dt. 19.02.2016,
Përgjigja e kompanisë rajonale pastrimi drejtuar PK-së dt. 10.03.2016
Përgjigja e ujësjellësit në Prishtinë , kartela financiare e konsumatorit S B për pronën në rrugën .. nr. 06 ... 11 , kartela financiare e konsumatorit S B për pronën në rr. .. – B – D-II-13- A-000 – 13 , kartele e vjetër financiare e konsumatorit S B për pronën Z3-S4-B-D-II-13-A, kartela financiare e konsumatorit S B për pronën në rrugën lagjja Mati – UB-I Dielli- 0048 të gjitha këto dt. 09.03.2016
Raporti informues i Policia e Kosovës nr.ref. 06/03/384/2015 dt.30.11.2015, lidhur me tëdhënat për automjetin .... Autorizimi i drejtuar për identifikim e sigurimit të informaci0onti për automjetin .. që pretendohet të jetë në pronësi të S B dt. 16.11.2015. Raporti i PK-së lidhur

2018:026156

me historinë e veturës ... nga importi e deri tek pronaret aktual dt. 31.11.2015.Përgjigja e drejtorisë së regjistrimit të automjeteve për veturën .. dt. 24.11.2015,
Regjistri për deklarimin e pasurisë për të akuzuarin S B e dt. 25,03. 2013, dt.11.03.2014, dt.27.03.2015.dhe dt. 29.03.2016,
Regjistri për deklarimin e pasurisë për të akuzuarin E B dt. 20.03.2015 dt. 18.03.2016,
Kontrata mbi shitblerjen vr. 23.a/2011 dt 27.12.2011 dhe Vr.nr.2018/12 dt.19.09.2012.(për ngastrën kat. nr. 1840-2 Certifikata e pronësisë 10-3589 dt.17.03.2014 Fatura tatimore e tatimit në pronë e E A B .

4.Mbrojtja e të akuzuarve:
4.1. I akuzuari S B , është deklarua te Prokurori i Shtetit me dt. 22.07.2014, në shqyrtim kryesorë është mbrojte në heshtje.
Në procedurën paraprake ka deklarua se posedon dhe është pronar i banesës që ndodhet në rrugën '... hyrja 13 nr. 13 në Prishtinë. Ajo fillimisht ka qenë pronë e përbashkët familjare e pas ndarjes më ka takua, por që në atë kohë kam qenë në procedurë për transferimin në emër të tim. Përveç tjerave posedoi veturën e tipit .. .., ... por që ende nuk e kam në emrin tim.

4.2. I akuzuari E B , është deklarua te Prokurori i Shtetit me dt. 22.08.2014, në shqyrtim kryesorë është mbrojte në heshtje.

Në procedurën paraprake te Prokurori i Shtetit ndër të tjera në mbrojtje ka deklarua: Posedoj shtëpinë e bashkësisë familjare në fshat dhe një shtëpi në rrugën .. në Klinë. Kemi pasuri të paluajtshme rreth 3 hektarë tokë pune, 2 hektarë pyllë të trashëguar dhe diku rreth 2 hektarë tokë pune e privatizuar që është pronë e përbashkët e bashkësisë familjare me vëllezër. Para tri javësh e kemi shkëputë bashkësinë familjare e kemi nda pasurinë por një pjesë ende nuk e kemi nda.

5.Fjala përfundimtare e palëve.
5.1 Prokurorja e Shtetit, fjalën përfundimtare e dha ne formë te shkruar, që i është bashkangjitë shkresave të lendes, e ajo tha:

Ne shqyrtim kryesorë me provat e administruara është provua qe te akuzuarit S B dhe E B se cili veç e veç i kanë kryer veprat penale mos raportimi apo raportimi rrem i te ardhurave dhuratave apo te dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 te KPPK-së.

Për këtë i propozoj gjykatës, qe te akuzuarit se cilin veç e veç, ti shpallë fajtor, ti gjykoj ne bazë te ligjit dhe ti detyron ne kompensimin e shpenzimeve te procedurës penale. Njërit ne kuptim te nenit 62 par.1 pika 2.3 te KPPK-se, te akuzuarve, secilit veç e veç të ju shqiptohet edhe dënimi plotësues, ndalimi ushtrimit të funksionit ne administratën publike .

5.2. Mbrojtësit e te akuzuarit S B , Av. Gëzim Kollqaku dhe av. Haxhi Millaku, fjalën përfundimtare e dhanë ne formë te shkruar, që i është bashkangjitë shkresave të lendes, e ata thanë:

Ne shqyrtim kryesorë nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale mos raportimi apo raportimi i rrem i pasurisë se te ardhurave apo dhuratave. Andaj i propozoj gjykatës qe te akuzuarin ta liron nga aktakuza .

Përveç faktit qe nuk është provua se është kryer vepra penale , mbrojtja konsideron se për lëshimet eventuale te pa qëllimta nga i akuzuari, e që ato lëshime mund te jen kundërvajtje, e

2018:026156

qe në fakt, nuk ka baz për shqiptim te dënimit e aqë më pak dëmin plotësues ndalim i ushtrimit te funksionit, sikur qe pretendon prokurori i shtetit .

I akuzuari S B ne fjalën përfundimtarë tha : Ne tersi i bashkëngjitëm fjalës përfundimtarë te dhen nga mbrojtja nuk e ndij veten fajtor .

5.3. Mbrojtësi i te akuzuarit E B Av, Gëzim Baloku ne fjalën përfundimtarë tha :
Ne shqyrtim kryesorë nuk është provua qe i akuzuari e ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet , ndërkaq me provat e administruara ne shqyrtim është provuar qe i akuzuari për pronën qe ai e ka posedua , ne vazhdimësi nga koha kur ai ka qen i detyruar sipas ligjit për deklarimin e pasurisë, ai e ka raportuar e qe këtë fakte e argumentojnë dëshmitë qe janë administrua ne shqyrtim kryesor. Mbi këto baza i propozoj gjykatës të i akuzuarit E B te lirohet nga aktakuza

I akuzuari E B ne fjalën përfundimtarë tha: Ne tersi i bashkëngjitëm fjalës përfundimtarë te dhen nga mbrojtja nuk kam çka te shtoj tjetër .

6.Vlerësimi I dëshmive formale:
6.1. Për të akuzuarin S B: Nga dëshmia Kontrata mbi dhuratën e banesës Vr.nr.7466/2006 dt.30.08.2006,e që Gjykata ja ka falë besimin., është vërtetua se i akuzuar S B ka qenë dhe është pronar i banesës që ndodhet në rrugën ‘.. hyrja 13 nr. 13 në Prishtinë. nga viti 2006 e së paku deri në fund të vitit 2016. Nga dëshmia kartela financiare e konsumatorit për pronën në rr. “...” – B – D-II-13- A-000 – 13, përkatësisht dhen nga Kompania për shpërndarjen e energjisë – EDS në Prishtinë dt. 19.02.2016, dhe dëshmia përgjigja kartela financiare e ujësjellësit në Prishtinë , pastaj dëshmia raporti i kompanisë rajonale pastrimi në Prishtinë dt. 09.03.2016,vërtetohet se i akuzuari ka qenë konsumator i energjisë dhe i ujitë si dhe shfrytëzues i shërbimeve të pastrimit, në banesën lëndore.

Nga dëshmia raporti informues i Policia e Kosovës nr.ref. 06/03/384/2015 dt.30.11.2015, lidhur me të dhënat për automjetin .... e që Gjykata ja ka falë besimin , është vërtetua se i akuzuari S B , edhe pse nuk ka qenë formalisht pronar, faktikisht ai ka ble dhe ka qenë pronar faktik i automjetin .. së paku nga viti 2014 deri në nëntor të viti 2015.

Sipas regjistrit për deklarimin e pasurisë për të akuzuarin S B dt. 25,03. 2013,vërtetohet se i akuzuari si pasuri të paluajtshme nuk e ka paraqitë pronën – banesën që e ka posedua në rr. “..” – B – D-II-13- A-000 – 13në Prishtinë. Gjithashtu nga regjistrat për deklarimin e pasurisë dt.11.03.2014 dhe dt.27.03.2015, edhe pse sikur që u provua se në vitin 2014 i akuzuari e ka ble veturën në vitin 2014 nuk i ka paraqitë si prona veturën .. .. e as banesën që e ka posedua në rr. “.” – B – D-II-13- A-000 – 13në Prishtinë.

Nga regjistrat për deklarimin e pasurisë dt. 29.03.2016, vërtetohet se i akuzuari si pasuri të paluajtshme nuk e ka paraqitë pronën – banesën që e ka posedua në rr. “.. .” – B – D-II-13- A-000 – 13në Prishtinë, e asë të dhënat për faktin e vërtetuar se ai e kishte shitë veturën .. ..

6.2. Për të akuzuarin E B: Nga dëshmitë kontrata mbi shitblerjen vr. 23.a/2011 dt 27.12.2011 dhe Vr.nr.2018/12 dt.19.09.2012.(për ngastrën kat. nr. 1840-2 Certifikata e pronësisë 10-3589 dt.17.03.2014 Fatura tatimore e tatimit në pronë e E A B, e që Gjykata ja ka falë besimin., është vërtetua se i akuzuari E B gjatë vitit 2015 dhe 2016, ka qenë pronar dhe obligues tatimor, i ngastrës kat. nr. 1840-2 Certifikata e pronësisë 10-3589.

2018:026156

Sipas regjistrit për deklarimin e pasurisë për të akuzuarin E B dt. 20.03.2015 dt. 18.03.2016, vërtetohet se i akuzuari si pasuri të paluajtshme nuk e ka paraqitë ngastrën kat. nr. 1840-2 Certifikata e pronësisë 10-3589 dt.17.03.2014

6.Vlerësimi mbrojtjes së të akuzuarve: Edhe pse të akuzuari S B dhe E B, në shqyrtim kryesorë janë mbrojtë në heshtje, sidoqoftë ata në proceduarën paraprake janë deklarua.

6.1. Avokatët mbrojtës të akuzuarit S B , pretendojnë se i akuzuari banesa në rr. ".. ." – B – D-II-13- A-000 – 13 në Prishtinë, është ble gjatë vitit 1999 me mjete të pasurisë së familjes së gjërë në të cilën ka jetua vëllai i të akuzuarit me familjen, e në fakt nuk ka qenë pronë e tij, e asë që ka marrë ndonjëherë qira sikur që akuzohet.

Në anën tjetër me që i akuzuari vazhdimisht për çdo vitë i ka lajmërua dy vetura, ndërkaq veturën ... , meqë nuk ka figurua në emër të tij. Në anën tjetër, me që i akuzuari nuk i është nënshtrua ndonjëherë kontrollit të plot të pasurisë për të vërtetua vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara, e që AKK me përgjigjejen dhen Prokurorit nr.02-722/13 dt.12.01.2016 , nuk ka mundë të konstatoi nëse ndonjëra prej veturave të deklaruara , është ajo vetura .... Mbrojtja konsideron se për lëshimet eventuale te pa qëllimta nga i akuzuari, e që ato lëshime mund te jenë kundërvajtje, në fakt, nuk ka bazë për shqiptim te dënimit e aqë më pak dëmin plotësues ndalim i ushtrimit te funksionit, sikur qe pretendon prokurori i shtetit .

Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësve në këto rrethana janë pjesërisht të pa bazuara dhe si të tilla për arsyet më poshtë të konstatuar, nuk i ka pranua në tersi.

I akuzuari pas fillimit të hetimit, me pretendim që të paraqitet se pronësinë faktikisht e ka fitua në vitin 2015 mbi bazën e kontratës mbi dhurimin, ai ka bërë kërkesë dhe i është lejua regjistrimi, me Aktvendimin mbi regjistrimin e pronës nr.011-952-1-1131 dt.29.04.2015 , e që Gjykata nuk e ka pranua. Kjo për faktin e pohuar dhe të vërtetuar edhe sipas dëshmive të konstatuar më lartë , se ai ka qenë pronar i banesës lëndore që nga viti 2006 , të cilën ja ka dhurua vëllai i tij .

Është pranua versioni i mbrojtjes se i akuzuari nuk ka marrë qera për banesën lëndore sikur që pretendon akuza se ai nuk i ka raportua ato të ardhura. Prokuror nuk ka prezantua asnjë provë për ta vërtetua këtë faktë.

Gjykata nuk e ka pranua pretendimin e mbrojtjes se, me që i akuzuari vazhdimisht për çdo vit i ka lajmërua dy vetura, e me që i akuzuari nuk i është nënshtrua ndonjëherë kontrollit të plot të pasurisë për të vërtetua vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara, e që nuk ka mundë të vërtetohet nëse ndonjëra prej veturave të deklaruara , është ajo vetura .... Kjo për faktin e vërtetuar se i akuzuari përveç veturave të deklaruara , ai në vitin 2014 e ka ble por që nuk e ka regjistrua në emër të vetë, të cilën më vonë e ka shitë, ai nuk e ka lajmërua në AKA.

6.2. Avokati mbrojtës të akuzuarit E B, pretendon se i akuzuari E, për pronën qe ai e ka posedua , ne vazhdimësi nga koha kur ai ka qen i detyruar sipas ligjit për deklarimin e pasurisë, ai nuk ka qenë pronarë i palujtëshmërisë lëndore, në fakt ajo pronë pas ndarjes së pasurisë i ka takua anëtareve tjerë të bashkësisë familjare.

Gjykata vlerëson se pretendimi mbrojtësit në këto rrethana është krejtësisht i pa bazuara e në kundërshtim me provat dhe si të tillë , Gjykata nuk e ka pranua .

2018:026156

Kjo për faktin e vërtetuar si në pikën **6.2.** se i akuzuari E B gjatë vitit 2015 dhe 2016, ka qenë pronar dhe obligues tatimor, i ngastrës kat. nr. 1840-2 Certifikata e pronësisë 10-3589. e që nga dëshmitë regjistrit për deklarimin e pasurisë dt. 20.03.2015 dhe dt. 18.03.2016, vërtetohet se i akuzuari si pasuri të paluajtshme nuk e ka paraqitë ngastrën kat. nr. 1840-2 Certifikata e pronësisë 10-3589 dt.17.03.2014.

7. Faktet e vërtetuara:

Pas administrimit te provave te propozuara nga palët të cilat gjykata i ka konsideruar si te rëndësishme për vendosjen e fakteve relevante ne këtë qeshtje penale , te njëjtat i ka vlerësuar një nga një dhe ne lidh mëri me njëra tjetrën ne kuptim te nenit 361 te KPPK-së, dhe ka vërtetua këtë gjendje faktike:

7.1. Faktet e pa kontestueshme e të mbështetura në provat formale e të cilave Gjykata ua ka falë besimin:

7.1.a. Nuk ishte kontestuese se i akuzuari S B në viti 2013 deri në vitin 2016 ka qenë në punë dhe detyra të punës, Kryetar i Komunës së Klinës ndërsa i akuzuari E B ka qenë në punë dhe detyra të punës, Nën-Kryetar i Komunës së Klinës , e që ata bëjnë pjesë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik , e që i janë nënshtrua detyrimit për deklarimin e pasurisë, të ardhurave dhe dhuratave sipas nenit 7 dhe 9 të ligjit nr.04/L-050

Është provua që i akuzuari S B, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Klinës-si zyrtari i lartë, sipas regjistrit për deklarimin e pasurisë, në vazhdimësi nga dt. 25,03. 2013 deri me dt. 29.03.2016, nuk e ka paraqitë pronën e përshkruar përkatësitë të vërtetuar si në pikën 6.1. të këtij arsyetimi.

Prokurori i Shtetit ka dështua të siguroj dëshmi për ta vërtetua pretendimin si në aktakuzë se i akuzuari S B, të ketë marrë qira për banesën që ndodhet në rr. ".." – B – D-II-13- A-000 – 13 në Prishtinë. Nuk ka pas dëshmi për ta provua pretendimin se i akuzuari përveç, veturave që i deklaroj dhe të asaj që u vërtetua që e kishte por që nuk e deklaroj, ta ketë posedua edhe një veturë tjetër të tipi ....

7.1.b.Është provua që i akuzuari E B në cilësinë e Nënë- Kryetarit të Komunës së Klinës-si zyrtari i lartë, sipas regjistrit për deklarimin e pasurisë, në vazhdimësi nga dt. 20.03.2015 deri me dt. 18.03.2016, nuk e ka paraqitë pronën e përshkruar, përkatësitë të vërtetuar si në pikën 6.2. të këtij arsyetimi.

8. Vlerësimi juridik i çështjes dhe vendimi i Gjykatës:

Neni 437 par.2 i KPK-së, përcakton elementet e nevojshme te veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare. Kjo vepër penale kryhet kur zyrtarët e lartë publik , e që i janë nënshtrua detyrimit për deklarimin e pasurisë, të ardhurave dhe dhuratave,me dashje veprojnë apo nuk veprojnë sipas nenit 7 dhe 9 të ligjit nr.04/L-050.

Në rastin konkretë është provua që të akuzuarit në cilësinë e zyrtarëve të lartë publik, secili veç e veç, i akuzuari S B , për çdo vit nga marsi i vitit 2013 deri në mars të vitit 2016 , ndërkaq i akuzuari E B për çdo vit nga marsi i vitit 2015 deri në mars të vitit 2016 ,nuk i kanë raportua në tersi pasurin që e kanë posedua.

Në fakt, veprimet e tyre për çdo vit ishin të njëjta e në lidhshmëri kohore të kryera nga i njëjti person, objekti i njejtë i veprës, shfrytëzimi i situatës apo mardhënjes së njejtë kohore, vendi ,

2018:026156

mënyra dhe dashja e kryerjes së veprimeve, e të cilat paraqesin një tersi sikur që përcakton dispozita e nenit 81 par 1 të KPK-së.

Andaj nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, Gjykata për hir të ruajtjes së identitetit të akuzës në kuptim të nenit 360 par.2 të KPPK-së, ka ndryshua përshkrimin e figurës së veprave penale dhe kualifikimin ligjor të tyre, me që ka vërtetua për tej çdo dyshimi, se i akuzuari S B, ditën, kohen , vendin dhe mënyrën e përshkruar ne piken II nënpika 1 te dispozitivit te aktgjykimit dhe i akuzuari E B, ditën, kohen , vendin dhe mënyrën e përshkruar ne piken II nënpika 2 te dispozitivit te aktgjykimit , secili veç e veç në vazhdimësi kanë krye vepër penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par.2 lidhur me nenin 81 par.1 i KPK-së. Për këtë, ata janë fajtorë dhe penalisht përgjegjës.

9. Vendimi mbi dënimin.

Me qe gjykata te akuzuarit i ka gjet fajtor dhe penalisht përgjegjës për veprat penale ne piken II nënpika 1 dhe 2 te dispozitivit te aktgjykimit, para se te vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, i ka marrë për bazë te gjitha rrethanat e përcaktuar me nenin 73 te KPK-së, e te cilat gjykata i ka vërtetua gjatë shqyrtimit gjyqësorë.
Rrethanë rënduese është marrë fakti se veprimet e tyre ,kanë bërë jehon të madhe në opinionin e gjer publik, ndërsa që rrethana tjera renduese për të akuzuarit Gjykata nuk ka gjet. Si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësua sjellja e tyre para dhe pas kryerjes se veprës penale- ata kishin një sjellje posaçërisht sociale dhe te pa qortueshme dhe faktin se ata me parë nuk kanë qen të gjykuar për ndonjë vepër penale.

Duke i vlerësua kështu të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato renduese , gjykata ka ardh ne përfundim se dënimi i shqiptuar është ne proporcion me shkallen e përgjegjësisë penale të te akuzuarit, rrezikshmërinë shoqërore te veprës penale te kryer dhe me intensitetin e pasojës se shkaktuar, e duke qen të sigurt se dënimi i shqiptuar është i baras-peshuar dhe do te jetë ne funksion të arritjes së qëllimit të dënimit , si preventiv për pengimin e te akuzuarit , por edhe te personave tjerë, nga kryerja e veprave penale dhe se fundi, një dënim i tillë dot e ndikoj ne risocializimin dhe riedukimin e te akuzuarit .

Gjykata nuk e ka pranua propozimin e Prokurorit të Shtetit, që ndaj të akuzuarve të shqiptohet edhe dënim plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike ose në shërbimin publik. Bazuar në rrethanat se si është krye vepra penale, që nuk lidhet drejtpërdrejt me detyrat e punës, në fakt nuk ka të bëj me keqpërdorim të detyrave, në anën tjetër bazuar në lartësinë e dënimit të shqiptuar, Gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit plotësues në këtë situatë, nuk ka arsyeshmëri.

10. Vendimi për shpenzimet e procedurës.

Vendimi qe i akuzuari te ja kompensoj gjykatës shpenzimet e procedurës penale ne forme paushallë është i bazuar ne nenin 99 par.1 dhe 2 pika 6 lidhur me nenin 102 par.1 ndërsa qe për shpenzimet tjera është vendosur qe tu ngarkohen mjeteve buxhetore te kësaj gjykate e ne kuptim te nenit 103 par.1 te KPPK-se.

11. Vendimi për kërkE për dëmshpërblim:

Me që pala e dëmtuar në raport me pjesën e aktgjykimit refuzues, nuk ka paraqitur kërkesë pronësoro-juridike, lidhur me këtë Gjykata fare nuk ka vendosë..

2018:026156

Nga sa u tha me lart është vendosur si ne dispozitiv te aktgjykimit .

U VENDOSE NE GJYKATEN THEMELORE –Departamenti për Rrime te Renda ne Peje , **me dt.29.05.2019**
DKR. P.nr.168/2016

Sekretarja Juridike
Binake Mulliqi

Kryetari i Trupit Gjykues -Gjyqtari
Sylë Lokaj

Anëtarët e trupit Gjykues-Gjyqtaret
1. Sami Sharragjiu d.v
2. Sejdi Blakaj, d.v.

UDHËZIM JURIDIK
Kundër këtij aktgjykimi eshët e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh , pas marrjes , Gjykatës se Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.

2018:026156